



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

STANDARDI I PROFESIONIT

Kultivues i rrushit

Spektori: Bujqësi

Kodi ISCO 88: 6112.11 Fermer, vreshtari

Grupi i njësive ISCO88 dhe ISCO08: 6112 Kultivues i kulturave të pemëve dhe shkurreve

Data e miratimit:

Ky standard i profesionit është zhvilluar me përkrahje të Projektit ALLED "Harmonizimi i arsimit me kërkesa të tregut të punës (Kosovë)"

Ekipi hartues:

Udhëheqës:

Josip Juračak, PhD

Anëtarë:

Sevdije Muhaxheri, Trajnere QAP

Bunjamin Alili

Data e miratimit:

I vlefshëm: Për periudhën prej vite

Kodi i profesionit: 6114 (ISCO 08)

Profesioni: Kultivues i rrushit

Përshkrimi i profesionit

Personat që kanë këtë profesion janë në gjendje të punojnë në ndërmarrje që merren me prodhimet e rrushit, vreshta, prodhimin e verës ose të rrushit të tryezës. Llojet e ndërmarrjeve që merren me prodhimin e rrushit mund të dallojnë sa i përket madhësisë.

Detyrat specifike të prodhuesit të rrushit përfshijnë: planifikimin e vreshtit, planifikimin e prodhimit të rrushit sipas burimeve në dispozicion dhe burimeve të arritshme; mbjelljen e vreshtit të ri; shumimin e hardhive; krasitjen dhe rregullimin e bimëve; menaxhimin e dheut; plehërimin; ujitjen; kontrollin e barojave të këqija, insekteve dhe sëmundjeve të rrushit; operacionet e vjeljes dhe pas vjeljes.

Për të qenë në gjendje të veprojnë si i vetpunësuar, përveç aktiviteteve operative të përmendura më lartë, prodhuesi i rrushit kryen edhe detyra të obligueshme administrative dhe komerciale.

Gjatë punës së tij/ saj, prodhuesi i rrushit duhet të aplikojë praktika të mira sa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë, mbrojtjes së ambientit dhe sigurisë së ushqimit.

Për të siguruar performancë të mirë dhe efikase në këtë profesion, duhet plotësuar kushtet në lidhje me tokën/ parcelën, punëtorinë, mjete adekuate të punës, pajisjet, lëndën e parë, materialet për paketim, si dhe udhëzimet me shkrim. Kushtet minimale që kërkohen duhet të krijojnë hapësirë për performancë të lehtë dhe efikase.

Gjatë ushtrimit të këtij profesioni, punëtorët mund t'i ekspozohen kushteve të pafavorshme të punës: temperatura ekstreme, nivel i lartë i lagështisë, mjete të mprehta, objekte rrotulluese, substanca toksike dhe punë të rënda fizike. Varësisht nga organizimi i punës, orari i punës mund të zgjatet gjatë natës, gjatë ditëve të pushimit ose edhe gjatë fundjavave. Nga kandidatët pritet të kenë shkathtësi të mira motorike, qëndrueshmëri fizike për aktivitete që kërkojnë fuqi, shikueshmëri dhe dëgjim të mirë. Kushtet e punës mund të shkaktojnë probleme për persona që janë alergjik ndaj polenit si dhe ndaj substancave të sakatuara kimike që përdoren në hortikulturë.

Profesioni: Kultivues i rrushit

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Planifikon dhe përgatit aktivitetet në fermën për kultivim të rrushit	Ky funksion ka të bëjë me planifikimin e aktiviteteve në fermë dhe përgatitjen e aktiviteteve për detyra operative. Planifikimi i aktiviteteve është i dyfishtë: (1) planifikimi i vreshtave të reja dhe (2) planifikimi i aktiviteteve të rregullta në vresht. Përgatitja e aktiviteteve përfshin sigurimin dhe kontrollimin e pajisjeve të duhura dhe të materialit. Kontrollimi duhet të përfshijë kushtet teknike të veglave dhe pajisjeve në fermë si dhe përmbushjen e kushteve për shëndet dhe siguri në punë.
2	Shumon dhe mbjellë hardhitë e rrushit	Pjesa e këtij funksioni që ka të bëjë me shumimin përfshin shartimin dhe rritjen e fidanëve të rrushit. Pjesa e mbjelljes ka të bëjë me mbjelljen e hardhive në përputhje me planin dhe me sistemin e përzgjedhur të dizajnit. Po ashtu përfshinë vendosjen e strukturës metalike mbështetëse në vresht.
3	Kryen detyra operative për kultivimin e rrushit	Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e aktiviteteve operative në vresht. Detyrat operative përfshijnë krasitjen, lidhjen, menaxhimin e dheut, kontrollin për baroja dhe insekte, ujitjen, plehërimin dhe vjeljen. Në rast të rrushit të tryezës, po ashtu përfshihen edhe aktivitetet e pas vjeljes deri te deponimi. Këto aktivitete mund të kryhen me pajisje manuale, gjysmë të automatizuara dhe të automatizuara. Detyrat duhet të kryhen në përputhje me instruksionet, standardet dhe udhëzimet për aplikimin e praktikave më të mirat të punës, përfshirë sigurinë, pastërtinë në punë dhe mbrojtjen e ambientit.
4	Kryen detyra të thjeshta administrative dhe komerciale	Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e detyrave administrative dhe komerciale që janë të nevojshme për udhëheqjen e punës në një ndërmarrje të vogël për kultivimin e rrushit. Funksioni përfshin kujdesin ndaj dokumenteve të punës, mbajtjen e shënimeve, kryerjen e llogarive të thjeshta; dhe promovimin e shitjen e prodhimeve të fermës.

Funksioni 1: Planifikon dhe përgatit aktivitetet në fermën për kultivim të rrushit

Ky funksion përfshin aktivite që kanë të bëjnë me planifikimin e vreshtave të reja dhe planifikimin e aktiviteve të rregullta në vresht. Kjo përfshin përzgjedhjen e varieteteve, vendime për sistemin e dizajnit të vreshtit, planifikimi i materialit të nevojshëm dhe përgatitjen e planit kohor të aktiviteve. Përgatitja e aktiviteve përfshin sigurimin dhe kontrollimin e pajisjeve të duhura dhe të materialit. Kontrollimi duhet të përfshijë kushtet teknike të veglave dhe pajisjeve në fermë si dhe përmbytjen e kushteve për shëndet dhe siguri në punë.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathësitë	Shkathësitë kryesore dhe shkathësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Planifikon aktivitetet për ndërtimin e vreshtit	<p>Përzgjedh varietetet e rrushit dhe fidanëve në përputhje me kushtet regionale dhe me qëllimet e prodhimit.</p> <p>Krijon afatet kohore për ndërtimin e vreshtit të ri duke përfshirë të gjithë hapat e nevojshëm.</p> <p>Krijon dizajnin e vreshtit në linjë me sistemin e dizajnit dhe me karakteristikat e parcelës së tokës.</p> <p>Planifikon materialet e nevojshme sipas llojit, sasisë dhe vlerës.</p>	<p>Llojet tipike të rrënjëve të hardhive</p> <p>Llojet e zakonshme të rrushit të tryezës dhe të verës</p> <p>Format dhe llojet e hardhive</p> <p>Fazat e rritjes së hardhisë</p> <p>Cikli vjetor i jetës së hardhisë</p> <p>Karakteristikat e dheut në nivel regional</p> <p>Kushtet dhe kërkesat për mbjellje të hardhisë</p>	<p>Interpretimi i udhëzimeve të shkruara për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve.</p> <p>Vizatimi i dizajnëve të thjeshta të plantacioneve</p> <p>Hartimi i planeve mbështetëse duke u bazuar në të dhënat në dispozicion.</p> <p>Matja me saktësi e sasisë, gjatësisë dhe këndit.</p> <p>Vërejtja e gabimeve dhe dështimeve në vendin e punës.</p> <p>Zgjedhja e problemeve që eliminohen lehtë në vendin e punës.</p> <p>Zbatimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p>	<p>Shkathësi të mira motorike.</p> <p>Shikim të mirë.</p> <p>Komunikimi në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Llogaritje bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm.</p> <p>Shkathësi për krahasim dhe klasifikim.</p> <p>Perceptim të mirë të kohës</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte me temperaturë të lartë dhe të zhurmshme.</p>
Harton planet e punës në vresht	<p>Krijon orarin e aktiviteve për kultivimin e dheut në linjë me praktiken për menaxhimin e dheut të përzgjedhur.</p> <p>Krijon orarin e aktiviteve për kontroll të insekteve në përputhje me ciklin vjetor të jetës së bimës.</p> <p>Planifikon materialin e nevojshëm sipas llojit, sasisë dhe vlerës</p>	<p>Hapat e procesit të ndërtimit të një vreshti</p> <p>Hapat e kultivimit të vreshtit gjatë vitit</p> <p>Llojet e dizajnit të mbjelljes</p> <p>Lënda e parë e zakonshme për kultivimin e rrushit</p> <p>Pajisjet e zakonshme manuale dhe të mekanizuara për kultivimin e rrushit</p>		
Bën përgatitjet për detyrat që kanë të	Përzgjedh dhe përgatit llojet dhe sasi të materialit të kërkuar për	Dështimet tipike të mjeteve dhe		

bëjnë me mbjelljen dhe prodhimin.	prodhim. Përgatit dhe kontrollon mjetet dhe pajisjet në linjë me aktivitetin e planifikuar. Rregullon vendin e punës në përputhje me kërkesat e aktivitetit të caktuar. Dallon dhe riparon çrregullimet e thjeshta në mjete dhe pajisje.	pajisjeve në fermë Pajisjet për shëndet dhe siguri në punë.		
-----------------------------------	---	--	--	--

Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion: tavolinë pune dhe pajisje të zyrës; nyje sanitare. Pasi që disa prej aktiviteteve mund të kryhen me më shumë efikasitet me anë të teknologjisë kompjuterike, për këtë funksion rekomandohet edhe posedimi i kompjuterit, printerit dhe qasjes në internet.

Përveç kushteve të përmendura më lartë, në vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet tjera mbrojtëse; manualët ose udhëzuesit e mjeteve dhe pajisjeve; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

Kërkesat e vlerësimit:

Test me shkrim, pyetjet dhe përgjigjet duhet të përdoren për të vlerësuar saktësinë e performimit të njohurive për bimën e hardhisë, lëndës së parë, dhe për detyrat që ndërlidhen me ndërtimin e vreshtit.

Kandidati duhet t'i nënshtrohet vlerësimit praktik në kushte të punës. Mbikëqyrja duhet të bëhet me qëllim të vlerësimit të plotësimit dhe saktësisë në kryerjen e aktiviteteve për planifikim dhe përgatitje të punës. Vlerësimi praktik duhet të marr parasysh po ashtu kriteret e performances.

Funksioni 2: Shumon dhe mbjellë hardhitë e rrushit

Ky funksion ka të bëjë me shumimin dhe mbjelljen e rrushit. Pjesa e funksionit që ka të bëjë me shumimin përfshin shartimin dhe rritjen e fidanëve. Pjesa e mbjelljes ka të bëjë me mbjelljen e hardhive në përputhje me planin dhe me sistemin e përzgjedhur të dizajnit. Po ashtu përfshinë vendosjen e strukturës metalike mbështetëse në vresht.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Shumon hardhitë e rrushit	<p>Përzgjedh kombinimet e duhura të rrënjëve dh pjesës për shartim sipas varietetit të rrushit dhe regjionit.</p> <p>Kryen shartimin me efikasitet dhe në mënyrë të suksesshme duke përdorë mjetet e duhura.</p> <p>Kujdeset për shartimet për të prodhuar fidanë cilësore</p>	<p>Llojet tipike të pjesëve për shartim</p> <p>Llojet dhe format e hardhive</p> <p>Karakteristikat e dheut në nivel regjional</p> <p>Agjentët e plehërimit</p> <p>Kushtet dhe kërkesat për mbjelljen e hardhive</p>	<p>Përdorimi me dorë i veglave me teh të mprehtë.</p> <p>Përdorimi me dorë i mjeteve për transport dhe mihje.</p> <p>Interpretimi i udhëzimeve me shkrim për përdorimin e veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Interpretimi i dizajnëve të vizatuara.</p>	<p>Shkathtësi të mira motorike.</p> <p>Shikim dhe dëgjim të mirë.</p> <p>Komunikimi në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Llogaritje bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm.</p> <p>Shkathtësi për krahasim dhe klasifikim.</p>
Kryen aktivitete në ndërtimin e vreshtit të ri	<p>Kryen aktivitetet e kërkuara në mënyrën e duhur për përgatitjen e tokës për vreshtin e ri</p> <p>Shënjon rreshtat dhe vendet për mbjellje në përputhje me dizajnin.</p> <p>Mbjell fidanët e rrushit duke respektuar udhëzimet për mbjellje.</p> <p>Vendos strukturën mbështetëse metalike në</p>	<p>Llojet e dizajnëve të mbjelljes</p> <p>Pajisjet e zakonshme manuale dhe mekanike për shartim</p> <p>Pajisjet e zakonshme manuale dhe mekanike për përgatitjen e dheut dhe për mbjellje</p> <p>Llojet e strukturave mbështetëse metalike që përdoren për kultivimin e rrushit.</p> <p>Dështimet tipike të mjeteve dhe pajisjeve në fermë</p> <p>Mjetet për shëndet dhe siguri në</p>	<p>Matja me saktësi e sasisë, gjatësisë dhe këndit.</p> <p>Vërejtja e gabimeve dhe dështimeve n vendin e punës.</p> <p>Zgjedhja e problemeve që eliminohen lehtë në vendin e punës.</p> <p>Zbatimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p>	<p>Perceptim të mirë të kohës</p> <p>Qëndrueshmëri fizike</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte të vështira.</p> <p>Tolerancë ndaj orarit të ndryshueshëm të punës</p> <p>Aftësi për të punuar në</p>

	mënyrë precize në përputhje me dizajnin e mbjelljes.	punë.		grup.
--	--	-------	--	-------

Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:

Për të qenë në gjendje të performojë aktivitetin që ka të bëjë me shumimin, punëtori duhet të ketë në dispozicion si vijon: materialin për shartim (dy pjesët e bimës për shartim, materialet shtesë), veglat për shartim, vend për mbajtjen e pjesëve të prera dhe të shartuara. Makina për shartim mund të përdoret nëse është e mundshme.

Për pastrimin e sipërfaqes dhe për kultivimin e thellë të dheut para mbjelljes së hardhive të reja, traktori ose makineria e rëndë duhet të jetë në dispozicion ose të huazohet.

Për mbjellje dhe për vendosje të strukturës mbajtëse shërbejnë mjaftueshëm veglat e dorës. Megjithatë puna është më efikase nëse në disa hapa përdoren pajisje mekanike, veçanërisht në hapësira të mëdha (pajisje për mihje, makinë për mbjellje, traktori me pajisjet përcjellëse). Materialet që nevojiten për mbjellje përfshijnë fertilizuesit, komposton ose plehun natyral, shkopinj druri, fidanët, ujë dhe material për lidhje.

Pos kësaj, në përputhje me kushtet e punës duhet të jenë në dispozicion edhe: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet tjera mbrojtëse; manualët ose udhëzuesit për përzgjedhje, paketim dhe deponim të perimeve; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

Kërkesat e vlerësimit:

Test me shkrim, pyetjet dhe përgjigjet duhet të përdoren për të vlerësuar njohuritë e kandidatit për llojet e rrënjëve, mënyrat e shartimit, metodat për përgatitjen e dheut, kushtet optimale të punës, dizajnet e mbjelljes, llojet e strukturave mbështetëse.

Shkathtësitë e punëtorit duhet të vlerësohen në kushte të punës. Mbikëqyrja duhet të bëhet me qëllim të vlerësimit të plotësisimit dhe saktësisë në kryerjen e aktiviteteve për planifikim dhe përgatitje të punës. Vlerësimi praktik duhet të marr parasysh po ashtu kriteret e performances.

Funksioni 3: Kryen detyra operative për kultivimin e rrushit.

Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e aktiviteteve operative në vresht. Detyrat operative përfshijnë krasitjen, lidhjen, menaxhimin e dheut, kontrollin për baroja dhe insekte, ujitjen, plehërimin dhe vjeljen. Në rast të rrushit të tryezës, po ashtu përfshihen edhe aktivitetet e pas vjeljes deri te deponimi. Këto aktivitete mund të kryhen me pajisje manuale, gjysmë të automatizuara dhe të automatizuara.

Detyrat duhet të kryhen në përputhje me instruksionet, standardet dhe udhëzimet për aplikimin e praktikave më të mirat të punës, përfshirë sigurinë, pastërtinë në punë dhe mbrojtjen e ambientit.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Kryen detyra operative në prodhimin e rrushit	<p>Bën kultivimin e dheut në linjë me praktikatat e përzgjedhura për menaxhim të dheut.</p> <p>Trajton fidanët e rrushit në përputhje me kushtet e tyre dhe me mënyrën e përzgjedhur.</p> <p>Krasit hardhitë e rrushit në linjë me llojin e tij dhe me sasinë e cilësinë e planifikuar të rrushit.</p> <p>Aplikon plehëruesit në mënyrë të sigurt dhe efikase në linjë me udhëzimet e dhëna.</p> <p>Zbaton masat për kontroll të barojave dhe insekteve në linjë me udhëzimet e dhëna dhe me kushtet e bimës.</p> <p>Përdor pajisjet për ujitje për të ujitur bimët sipas nevojës.</p>	<p>Varietetet dhe klasat e zakonshme të rrushit të tryezës dhe të verës.</p> <p>Format dhe llojet e hardhive</p> <p>Fazat e rritjes së hardhisë.</p> <p>Cikli vjetor i jetës së hardhisë.</p> <p>Njohuri bazike për veglat dhe pajisjet që përdoren në vresht.</p> <p>Insektet më të zakonshme që sulmojnë rrushin.</p> <p>Metodat për parandalimin e sëmundjeve të bimës në prodhimtarinë e rrushit në mënyrë konvencionale dhe organike.</p> <p>Përbërësit më të zakonshëm aktiv për mbrojtje të bimës në prodhimtarinë e rrushit në mënyrë konvencionale dhe</p>	<p>Ndjekja e udhëzimeve për përdorim të veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Ndjekja e udhëzimeve për procesin e prodhimit</p> <p>Përdorimi i veglave manuale në fermë.</p> <p>Përdorimi i pajisjeve të zakonshme mekanike të fermës.</p> <p>Caktimi me saktësi i kohës, sasisë dhe gjatësisë.</p> <p>Vërejtja e problemeve në material dhe pajisje.</p> <p>Zgjedhja e problemeve që eliminohen lehtë në vendin e punës.</p>	<p>Shkathtësi të mira motorike.</p> <p>Sens të mirë të shikimit, dëgjimit, nuhatjes dhe prekjës.</p> <p>Komunikimi në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Llogaritje bazike me numra të plotë dhe të pjesëshëm.</p> <p>Shkathtësi për krahasim dhe klasifikim.</p> <p>Perceptim të mirë të kohës</p> <p>Qëndrueshmëri fizike</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte të këqija të motit.</p> <p>Tolerancë ndaj orarit të</p>
Vjel rrushin për verë dhe rrushin e tryezës	<p>Kontrollon pjekurinë dhe cilësinë e rrushit në raport me qëllimin përfundimtar.</p>			

	<p>Vjel rrushin në mënyrë efikase dhe me kohë me dorë ose me makineri.</p> <p>Transporton produktin e vjelur me kohë me dëme dhe humbje minimale.</p> <p>Klasifikon rrushin e tryezës në përputhje me standardet nëse kërkohet Paketon dhe etiketon rrushin e tryezës në mënyrën e duhur.</p> <p>Deponon rrushin në kushte adekuate.</p>	<p>organike</p> <p>Plehu organik dhe inorganik dhe substanca tjera ushqyese për bimën.</p> <p>Metodat dhe pajisjet për ujitje</p> <p>Shenjat e pjekurisë së perimeve për vjelje.</p> <p>Veglat e dorës për të kontrolluar cilësinë e rrushit.</p>	<p>Zbatimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p> <p>Aplikimi i praktikave të mira për menaxhim të mbeturinave.</p>	<p>ndryshueshëm të punës</p> <p>Aftësi për të punuar në grup.</p>
<p>Mirëmban shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mbrojtjen e ambientit</p>	<p>Kontrollon pajisjet e punës dhe mban ato operacionale dhe në rregull.</p> <p>Aplikon masa të përshtatshme kundrejt rreziqeve potenciale të shëndetit dhe sigurisë në punë.</p> <p>Mban vendin e punës të sigurte dhe të pastër pa shkaktuar dëme në ambient.</p> <p>Ndërmerr hapat e duhur në rast të gabimeve apo dështimeve gjatë procesit të prodhimit.</p> <p>Trajton mbeturinat në mënyrën e duhur.</p>	<p>Pajisjet manuale dhe mekanike për vjelje.</p> <p>Transportimi dhe paketimi i kontejnerëve me rrush të tryezës.</p> <p>Kushtet e deponimit të rrushit të tryezës.</p> <p>Rregullat kryesore për shëndet dhe siguri në punë.</p> <p>Rregullat kryesore për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit nëhortikulturë.</p>		

Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:

Për të kryer këtë funksion nevojitet një veshtë. Duhet pasur në dispozicion vegla adekuate të punës (sharra, grabuja, shati, lopata, kazma, tërfurku, sëpata, drapri, gërshërë për shartim). Rekomandohet të jenë në dispozicion edhe pajisje mekanike si traktori dhe pajisjet shtesë të traktorit (lërues, shpërndarës i plehut, spërkatës, pajisje për kositje) dhe makina për kositje. Pompa dhe mjet për shpërndarje të ujit nevojiten për ujitje. Produkte dhe furnizime të ndryshme nevojiten për të ushtruar këtë funksion: pleh, herbicide dhe pesticide të tjera, ujë për ujitje, material për lidhje, e të ngjashme.

Pajisje manuale ose mekanike për vjelje; pajisje transportuese duhet të jenë në dispozicion me rastin e vjeljes. Pos kësaj, duhet të ketë në dispozicion edhe materiale për paketim, etiketim si dhe vend për deponim të rrushit të tryezës.

Pos kësaj, në përputhje me kushtet e punës duhet të jenë në dispozicion edhe: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet tjera mbrojtëse; manualët ose udhëzuesit për përdorim të veglave dhe pajisjeve; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

Kërkesat e vlerësimit:

Test me shkrim, pyetjet dhe përgjigjet duhet të përdoren për të vlerësuar njohuritë e kandidatit për ciklin vjetor të jetës së hardhisë, kërkesat e bimës sa i përket dheut dhe klimës, rregullat e krasitjes, kontrolli i barojave dhe sëmundjeve të bimës si dhe rregullat për klasifikimin e rrushit të tryezës.

Kandidati duhet t'i nënshtrohet vlerësimit praktik në kushte të punës. Mbikëqyrja duhet të bëhet me qëllim të vlerësimit të plotësimit dhe saktësisë në kryerjen e aktiviteteve për planifikim dhe përgatitje të punës. Vlerësimi praktik duhet të marr parasysh po ashtu kriteret e performances.

Funksioni 4: Kryen detyra të thjeshta administrative dhe komerciale.

Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e detyrave administrative dhe komerciale që janë të nevojshme për udhëheqjen e punës në një ndërmarrje të vogël për kultivimin e rrushit. Funksioni përfshin kujdesin ndaj dokumenteve të punës, mbajtjen e shënimeve, kryerjen e llogarive të thjeshta; dhe promovimin e shitjen e prodhimeve të fermës.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Kryen punë administrative	<p>Mban shënime për llojet dhe sasi të materialeve prodhuese dhe të prodhimeve.</p> <p>Bën llogaritje bazike për të caktuar të hyrat , kostot dhe çmimet.</p> <p>Kujdeset për dokumentacionin për të siguruar llogarimbajtje të mirë dhe të saktë.</p>	<p>Njohuri mbi forma dhe dokumentacione të zakonshme të biznesit.</p> <p>Njohuri bazike mbi buxhetimin.</p> <p>Njohuri mbi kërkesat ligjore për shitjen e rrushit.</p>	<p>Saktësi në mbajtjen e shënimeve biznesore.</p> <p>Mbajtja në rregull e dokumenteve të biznesit.</p> <p>Kalkulime të thjeshta financiare.</p> <p>Lëshimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me shitjen.</p>	<p>Komunikimi në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Llogaritje bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm.</p> <p>Tolerancë ndaj orarit të ndryshueshëm të punës.</p>
Kryen punë komerciale	<p>Rregullon dhe dekoron vendin e shirjes sipas kërkesave të produktit dhe preferencave të blerësve.</p> <p>Promovon produktet duket përdorë teknika adekuate të promovimit</p> <p>Lëshon fatura dhe oferta të rregullta.</p> <p>Kryen shitjen në përputhje me praktikat më të mira dhe me legjislacionin në fuqi</p>	<p>Njohuri mbi mënyrat e thjeshta të promovimit.</p> <p>Njohuri mbi kërkesat për shëndet dhe siguri në punë.</p>	<p>Përdorimi i pajisjeve teknologjike për komunikim nëse janë në dispozicion</p> <p>Përdorimi i teknologjisë informative në zyre nëse është në dispozicion</p> <p>Dekorimi i pikës së shitjes.</p> <p>Komunikimi me gojë dhe me shkrim me blerësit.</p>	

Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion burimet si vijon: tavolinë pune; furnizime të zyrës; shembuj/ forma të korrespondencës në letër dhe në version elektronik, kalkulator, telefon dhe një pikë shitje të mobiluar.

Përveç burimeve të përmendura më lartë, rekomandohet që për këtë funksion të jetë në dispozicion edhe një kompjuter me printer dhe me qasje në internet, ose një regjistrator i parave/ keshit.

Kërkesat e vlerësimit:

Testi me shkrim dhe pyetje – përgjigje, për të demonstruar njohuritë dhe shkathhtësitë që ndërlidhen me aktivitetet kryesore. Vlerësimi duhet të përfshijë llogaritje.

Kandidati duhet të vlerësohet për performancën e tij/ saj në kryerjen e aktiviteteve si vijon: hartimi i dokumenteve të biznesit, shitja. Vlerësimi duhet të bazohet në krahasimin mes arritjeve të kandidatit në raport me praktiken e rekomanduar dhe me kriteret e performancës.